



PARIMET KRYESORE PËR BIZNES DHE TË DREJTA TË NJERIUT



ZBATIMI I KORNIZËS SË KOMBEVE
TË BASHKUARA PËR "MBROJTJE,
RESPEKTIM DHE MJETE JURIDIKE"



SHKUP 2019



Nxjtja e parimeve për biznes
dhe të drejta të njeriut
Projekti është i financuar
nga Bashkimi Evropian



Business Confederation of Macedonia

KONEKT

PARIMET KRYESORE PËR BIZNES DHE TË DREJTA TË NJERIUT:

ZBATIMI I KORNIZËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR
"MBROJTJE, RESPEKTIM DHE MJETE JURIDIKE"

KOMBET E BASHKUARA
TË DREJTA TË NJERIUT
ZYRA E KOMISARIT TË LARTË

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Shoqatës Konekt dhe autorëve të përmbajtjes dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqet qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Ky publikim është përkthim jozyrtar për të cilin botuesi e pranon përgjegjësinë e plotë.

Publikimi është publikuar për dhe në emër të Kombeve të Bashkuara.

Redaktor: Shoqata Konekt Shkup
Botues: Projekti: Nxitja e parimeve për biznes dhe të drejta të njeriut
Për botuesin: Nikica Kusinikova, Shoqata Konekt
Përktheu dhe lektoroi: Lingua Ekspert SHPK Shkup
Shkup, shkurt 2019

ВОДЕЧКИ ПРИНЦИПИ АЛБАНСКИ

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

334.72:342.72(73):340.13

PARIMET kryesore për biznes dhe të drejta të njeriut : zbatimi i kornizës së Kombeve të bashkuara për „Mbrotjtje, respektim dhe mjete juridike“. - Shkup : Shoqata Konekt, 2019. - IV, 36 стр. ; 21 см

Publikacijata e во рамките на проектот: „Nxitja e parimeve për biznes dhe të drejta të njeriut“

ISBN 978-608-4835-06-6

a) Претпријатија - Човековите права и слободи - Правна рамка COBISS.MK-ID 109709066

Shënim

Simbolet e përdorura dhe materiali i prezentuar në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehjen e mendimit nga Sekretariati i Kombeve të Bashkuara lidhur me statusin juridik të cilitdo shtet, territor, qytet apo rajon, apo autoriteteve të tyre, ose në raport me përcaktimin e kufijve të tyre.

Simbiotet në dokumentet e Kombeve të Bashkuara përbëhen prej shkronjave të mëdha në kombinim me numra. Përmendja e një numri të tillë tregon për referencën ndaj një dokumenti të Kombeve të Bashkuara.

HR/PUB/11/04

© 2011 Kombet e Bashkuara për versionin në gjuhën angleze
© 2019 Kombet e Bashkuara për versionin në gjuhën maqedonase
Të gjitha të drejtat në nivel botëror janë të rezervuara

PËRMBAJTJA

I. OBLIGIMI I SHTETIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT	9
A. PARIME KRYESORE	9
B. PARIME OPERATIVE	11
II. PËRGJEGJËSI KORPORATIVE PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT	20
A. PARIME KRYESORE	20
B. PARIME OPERATIVE	23
III. QASJA DREJT MJETEVE JURIDIKE	34
A. PARIME KRYESORE	34
B. PARIME OPERATIVE	35

Ky publikim i përmban "Parimet kryesore për biznes dhe të drejta të njeriut: Implementimi i kornizës së Kombeve të Bashkuara për "Mbrojtje, respektim dhe mjete juridike", të përgatitura prej Përfaqësuesit të posaçëm të Sekretarit të përgjithshëm për të drejta të njeriut dhe korporata trans-kombëtare dhe ndërmarrje të tjera afariste. Përfaqësuesi i posaçëm i përfshiu Parimet kryesore në raportin e tij përfundimtar deri tek Këshilli për të drejta të njeriut (A/HRC/17/31), që përfshin edhe hyrjen për Parimet kryesore dhe shqyrtimin e procesit që çoi drejt përgatitjes së tyre.

Këshilli për të drejta të njeriut i miratoi Parimet kryesore me vendimin e tij 17/4 prej 16 qershorit 2011.

PARIME TË PËRGJITHSHME

Këto parime të përgjithshme bazohen në:

- (a) Obligimet e vauhdueshme të shteteve për t'i respektuar, mbrojtur dhe plotësuar të drejtat dhe liritë fundamentale të njeriut;
- (b) Rolin e ndërmarrjeve afariste si organe të specializuara në shoqëri të cilat kryejnë funksione të specializuara dhe të cilat duhet të punojnë në pajtim me të gjitha ligjet në fuqi dhe t'i respektojnë të drejtat e njeriut;
- (c) Në nevojën të drejtat dhe obligimet të shoqërohen me instrumente juridike përkatëse dhe efektive në rast të shkeljes së tyre.

Këto parime kryesore kanë të bëjnë për të gjitha shtetet dhe të gjitha ndërmarrjet afariste, si të atyre transnacionale ashtu edhe të gjitha të tjerat, pavarësisht madhësisë së tyre, sektorit, lokacionit, pronësisë dhe strukturës.

Këto parime kryesore duhet të merren si tërësi koherente dhe duhet të interpretohen, në mënyrë të veçantë dhe të gjitha së bashku, nga aspekti i qëllimit të tyre për përmirësimin e standardeve dhe praktikave lidhur me biznesin dhe të drejtat e njeriut në drejtim të ngritjes së rezultateve të dukshme për individë dhe bashkësi të involvuara, duke kontribuar më pas, drejt vendosjes së një globalizimi të qëndrueshëm shoqëror.

Asnjë pjesë e këtyre Parimeve kryesore nuk duhet të interpretohet si krijim i obligimeve të reja ndërkombëtare-juridike e as si kufizim apo minim i cilitdo obligim ligjor që një shtet mund ta ndërmarrë apo i cili e ka sipas ligjeve ndërkombëtare për të drejta të njeriut.

Këto parime kryesore duhet të implementohen në një mënyrë jodiskriminatore, me ç'rast vëmendje të veçantë do t'u kushtohet nevojave dhe sfidave me të cilat ballafaqohen individët të cilët janë pjesë grupeve apo popullatës e cila mund të jetë e rrezikuar për t'u bërë e ndjeshme apo e marginalizuar, ndërsa do të merren parasysh rreziqet e ndryshme me të cilat ballafaqohen gratë dhe burrat.



I. OBLIGIM I SHTETIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

A. PARIME KRYESORE

1. Shtetet duhet të sigurojnë mbrojtje prej keqpërdorimit të të drejtave të njeriut në territorin e tyre dhe/apo jurisdiksionin prej palëve të treta, duke i përfshirë këtu edhe ndërmarrjet afariste. Që këtu, është e domosdoshme ndërmarrja e hapave përkatës për parandalimin, hulumtimin, dënimin dhe restitucionin e keqpërdorimeve të tilla përmes vendosjes së politikave efektive, legjislaturës, rregullave dhe mbrojtjes gjyqësore.

Koment

Obligimet e shteteve të cilat dalin prej të drejtës ndërkombëtare për të drejta të njeriut u imponojnë t'i respektojnë, mbrojnë dhe plotësojnë të drejtat e njeriut individëve në territorin dhe jurisdiksionin e tyre. Kjo e përfshin edhe obligimin për mbrojtje nga keqpërdorimi i të drejtave të njeriut prej palëve të treta, duke i përfshirë edhe prej ndërmarrjeve afariste.

Obligim i shtetit për të siguruar mbrojtje është standard i sjelljes. Që këtu, shtetet si të tilla nuk janë përgjegjëse për keqpërdorimet e të drejtave të njeriut prej faktorëve privatë. Por, shtetet mund t'i shkelin obligimet e tyre të cilat dalin prej të drejtës ndërkombëtare për të drejta të njeriut nëse keqpërdorimi i tillë mund t'u përshkruhet atyre apo nëse shteti nuk ka ndërmarrë hapa përkatës për parandalimin, hulumtimin, dënimin dhe mjete juridike lidhur me keqpërdorimet nga faktorët privatë. Edhe ose, në përgjithësi, shtetet kanë liri veprimi për të vendosur se çfarë hapash do të ndërmarrin, ato duhet t'i shqyrtojnë të gjitha masat e lejuara parandaluese dhe korrektive, duke i përfshirë këtu edhe politikën, legjislaturën dhe mbrojtjen gjyqësore. Gjithashtu, shtetet kanë për obligim ta mbrojnë dhe ta zhvillojnë qeverisjesn e së drejtës, duke e përfshirë edhe atë përmes ndërmarrjes së masave me të cilat do të sigurohet barazi para ligjit, zbatimit të tij fillestar dhe nivelit përkatës të llogaridhënies, sigurisë juridike dhe procedurale dhe transparencës juridike.

Ky kapitull përqendrohet në masat parandaluese ndërsa, nga ana tjetër, Kapitulli III i përcakton masat korrektive.

- 2. Shtetet duhet në mënyrë të qartë t'i përcaktojnë pritjet se të gjitha ndërmarrjet afariste me seli në territorin e tyre dhe/apo në jurisdiksionin e tyre do t'i respektojnë të drejtat e njeriut përmes punës së tyre.**

Koment

Për momentin, sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejta të njeriut, shtetet në përgjithësi nuk obligohen t'i rregullojnë aktivitetet ekstraterritoriale të ndërmarrjeve afariste me seli në territorin e tyre dhe/apo nën jurisdiksionin e tyre. Gjithashtu, në përgjithësi, nuk u ndalohet as ta bëjnë atë, me kusht që të ekzistojë bazë juridike e njohur për atë. Në kuadër të këtyre parametrave, disa prej trupave të formuar në bazë të kartave për të drejta të njeriut rekomandojnë shtetet amë të ndërmarrin hapa për parandalimin e keqpërdorimeve jashtë vendit prej ndërmarrjeve afariste të cilat janë nën jurisdiksionin e tyre.

Në politikat janë përcaktuar argumente të fuqishme se pse shtetet amë duhet në mënyrë të qartë t'i theksojnë pritjet se ndërmarrjet afariste do t'i respektojnë të drejtat e njeriut jashtë vendit, veçanërisht atje ku edhe vetë shteti është përfshirë ose i mbështet këto ndërmarrje. Argumentet përfshijnë sigurimin e parashikueshmërisë për ndërmarrjet afariste përmes dërgesës së mesazheve koherente dhe konsistente, si dhe ruajtjes së prestigjit të shtetit.

Shtetet kanë miratuar qasje të ndryshme në këtë drejtim. Disa prej tyre janë masa vendore për implikime ekstraterritoriale. Disa prej shembujve përfshijnë kërkesa kompanitë-amë të njoftojnë për punën globale të gjithë ndërmarrjes; zbatohen instrumente multilaterale të së drejtës së butë, siç janë Drejtimet për ndërmarrje multinacionale të Organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim; dhe standarde në punë të cilat mund t'i kërkojnë institucionet të cilat mbështesin investime të jashtme. Qasjet e tjera përfshijnë dhe legjislativë të drejtpërdrejt ekstraterritoriale dhe zbatimin e saj. Këtu bëjnë pjesë edhe sistemet penalo-juridike të cilat e lejojnë përndjekjen në bazë të shtetësisë së autorit pavarësisht vendit se ku kryhet vepra. Faktorë të ndryshëm mund të kontribuojnë për arsyeshmërinë e perceptuar dhe faktike të masave të shteteve, si për shembull, nëse ato bazohen ndaj ndonjë marrëveshje multilaterale.

B. PARIME OPERATIVE

FUNKSIONE TË PËRGJITHSHME DHE RREGULLATORE TË SHTETEVE

3. Me qëllim të plotësimit të obligimit për sigurimin e mbrojtjes, shteti duhet të:
 - (a) Zbatojë ligje të cilat kanë për qëllim apo rezultojnë me kërkesë prej ndërmarrjeve afariste për t'i respektuar të drejtat e njeriut dhe në mënyrë periodike ta vlerësojnë përshtatshmërinë e këtyre ligjeve dhe t'i plotësojnë të gjitha zbrazëtitë e përcaktuara;
 - (b) Sigurojnë se ligjet e tjera me të cilat rregullohet themelimi dhe puna vijuese e ndërmarrjeve afariste, si për shembull Ligji për shoqëritë tregtare, nuk i kufizon, por u mundëson ndërmarrjeve t'i respektojnë të drejtat e njeriut;
 - (c) U japin drejtime efektive ndërmarrjeve afariste për atë se si t'i respektojnë të drejtat në punën e përgjithshme;
 - (ç) I inkurajojnë, ndërsa aty ku është e mundur edhe të kërkojnë ndërmarrjet afariste të sigurojnë informacione për atë se si duhet të ballafaqohen me ndikimin e tyre ndaj të drejtave të njeriut.

Koment

Shtetet nuk duhet të fillojnë nga supozimi se ndërmarrjet afariste gjithmonë preferojnë ose përfitojnë nga pasiviteti i shtetit dhe duhet t'i shqyrtojnë mundësitë për të përdorur një kombinim të zgjuar të masave të ndryshme - kombëtare dhe ndërkombëtare, të detyrueshme dhe vullnetare - me qëllim që të nxitet respektimi i të drejtave të njeriut nga ndërmarrjet afariste.

Dështimi për të zbatuar ligjet në fuqi që rregullojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi respektimin e të drejtave të njeriut në punën afariste ose biznes shpesh përbën një boshllëk të rëndësishëm ligjor në praktikën e shtetit. Ligje të tilla mund të përfshijnë ligjet e mosdiskriminimit dhe të marrëdhënies së punës, e deri tek ligjet për mjedis jetësor, pronësinë, privatësinë dhe parandalimin e korrupsionit. Prandaj, është e rëndësishme që shtetet të vlerësojnë nëse ligjet e tilla aktualisht po zbatohen në mënyrë efektive dhe nëse nuk është kështu, t'i përcaktojnë arsyet dhe masat që mund ta korrigjojnë këtë situatë. Është po aq e rëndësishme që shteti të rishikojë nëse këto ligje kanë përfshirje të mjaftueshme, duke e pasur parasysh zhvillimin e rrethanave dhe nëse, së bashku me politikat relevante, ato sigurojnë një mjedis të favorshëm për respektimin e të drejtave të njeriut në punën afariste. Për shembull, shpesh ka nevojë për qartësi më të madhe në disa fusha të ligjit dhe politikave, si për shembull tek ato që rregullohet qasja deri tek toka, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për pronësi ose përdorimin e tokës, me qëllim të mbrojtjes së bartësve të së drejtave dhe ndërmarrjeve afariste.

Ligjet dhe politikat që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve afariste, siç janë ligjet e shoqërive tregtare apo të letrave me vlerë, formojnë drejtpërdrejtë sjelljen e biznesit. Megjithatë, ndikimi i tyre në të drejtat e njeriut mbetet i pamjaftueshëm. Për shembull, ligjet e kompanive apo të letrave me vlerë nuk i përcaktojnë në mënyrë të mjaftueshme aktivitetet e lejuara, madje edhe më pak, cilat janë aktivitete të detyrueshme të ndërmarrjeve afariste dhe menaxherëve të tyre lidhur me të drejtat e njeriut. Ligjet dhe politikat në këtë fushë duhet të ofrojnë udhëzime të mjaftueshme për ndërmarrjet që të jenë në gjendje t'i respektojnë të drejtat e njeriut, duke e pasur parasysh rolin e strukturës ekzistuese të qeverisjes, siç janë bordet drejtuese.

Drejtimit për ndërmarrjet afariste për respektimin e të drejtave të njeriut duhet të tregojnë për rezultatet e pritura dhe të ndihmojnë më ndarjen e praktikave më të mira. Ato duhet të përmbajnë këshilla për metoda përkatëse, duke përfshirë edhe për analizën e thellë për të drejtat e njeriut dhe për mënyrën se si në mënyrë efektive të shqyrtohen çështjet gjinore, ndjeshmëria dhe/apo marginalizimi, njohja dhe sfidat specifike me të cilat mund të ballafaqohen popullata vendore autoktone, gratë, pakicat kombëtare dhe etnike, pakicat religjioze dhe gjuhësore, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët-emigrantë dhe familjet e tyre.

Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut të cilat punojnë në pajtim me Parimet e Parisit kanë rol të rëndësishëm në ndihmesën e shteteve për të përcaktuar nëse legjislatura relevante është në pajtim me obligimet e tyre lidhur me të drejtat e njeriut dhe nëse kjo në mënyrë efektive zbatohet, si edhe në dhënien e udhëzimeve për ndërmarrjet afariste dhe faktorët e tjerë joshtetërorë lidhur me të drejtat e njeriut.

Komunikimi me ndërmarrjet afariste lidhur me mënyrat në të cilat ballafaqohen me ndikimin e tyre ndaj të drejtave të njeriut mund të përfshijë nga komunikimi joformal me faktorët e prekur e deri tek raportimi formal publik. Inkurajimi, aty ku është përkatëse a edhe kërkesë e komunikimit të tillë nga shteti është e rëndësishme të stimulohet respektimi i të drejtave të njeriut nga ndërmarrjet afariste. Stimulimi për t'u kumtuar informacionet përkatëse mund të jetë në formë të dispozitave të cilat do t'i japin peshë raportimit të tillë për punën personale lidhur me çfarëdo procedure gjyqësore apo administrative. Kuntimi i obligueshëm mund të jetë veçanërisht përkatës kur natyra e punës afariste apo konteksti në të cilin punohet paraqesin rrezik të konsiderueshëm për të drejtat e njeriut. Politikat apo ligjet në këtë sferë mund të japin sqarime të dobishme për atë se si duhet të komunikojnë ndërmarrjet afariste, duke e ndihmuar më tej, sigurimin e qasjes dhe saktësisë së informacioneve të transmetuara.

Çdo vendim i cili përcakton komunikim përkatës duhet t'i marrë parasysh rreziqet të cilat ai mund t'i shkaktojë për sigurinë e individëve dhe kapaciteteve; kërkesat legjitime për fshehtësi komerciale; dhe dallimet në madhësinë dhe strukturën e kompanive.

Kërkesat për raportim financiar duhet të sqarojnë se ndikimi ndaj të drejtave të njeriut në disa raste mund të jetë "material" apo "i rëndësishëm" për punën ekonomike të ndërmarrjes afariste.

LIDHJA SHTET - BIZNES

4. Shtetet duhet të ndërmarrin hapa plotësues për mbrojtjen prej keqpërdorimeve të të drejtave nga ndërmarrjet afariste të cilat janë në pronë ose janë nën kontrollin e shtetit, ose të cilat fitojnë mbështetje dhe shërbime të konsiderueshme prej agjencive shtetërore, si për shembull agjencitë të cilat japin kredi për eksport, apo agjenci të cilat japin garanci shtetërore për investim apo garanci të tjera, përfshirë edhe aty ku është përkatëse ose përmes kërkesës për t'u bërë analizë e thellë lidhur me të drejtat njeriut.

Koment

Në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, çdo shtet në veçanti është bartës kryesor i obligimeve, ndërsa të gjitha shtetet së bashku janë mbrojtës të sistemit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kur një ndërmarrje afariste është nën kontrollin e shtetit apo kur veprimi i saj mund t'i përshkruhet në një mënyrë tjetër shtetit, shkëlja e të drejtave të njeriut nga ndërmarrja do të thotë edhe shkëlje e obligimeve ndërkombëtare juridike të vetë shtetit. Mbi këtë, aq sa ndërmarrja afariste është më afër shtetit ose sa më shumë varet prej organeve të vendosura në pajtim me ligjin ose me mbështetjen e obliguesve tatimorë, aq më i fuqishëm do të ishte shkaku për të cilin shteti do të duhet të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut prej kësaj ndërmarrje afariste.

Kur shtetet i ndajnë apo i kontrollojnë ndërmarrjet afariste, atëherë ato kanë mundësi më të mëdha në kornizat e autorizimeve të tyre të sigurojnë zbatimin e politikave relevante, legjislativë dhe rregulla lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Zakonisht, udhëheqësia më e lartë dorëzon raporte deri tek agjencitë shtetërore, ndërsa disa sektorë të caktuar shtetërorë kanë autorizime më të mëdha për të kryer kontroll dhe mbikëqyrje, si dhe që të sigurojnë zbatim efektiv të analizës së thellë për të drejtat e njeriut. (Këto ndërmarrje i nënshtrohen edhe përgjegjësisë korporative për respektimin e të drejtave të njeriut, për të cilën do të flitet në Kapitullin II).

Një sërë agjencish, në mënyrë formale apo joformale të lidhura me shtetin, mund t'u ofrojnë mbështetje dhe shërbime ndërmarrjeve afariste në punën e tyre. Këtu bëjnë pjesë agjenci për kredi për eksport, agjenci të cilat japin garanci shtetërore për investim dhe garanci të tjera, agjenci zhvillimore dhe institucione për zhvillim financiar. Gjithmonë kur në mënyrë eksplicite nuk do t'i përfshijnë ndikimet reale dhe potenciale negative që ndërmarrjet – shfrytëzuese mund t'i kenë ndaj të drejtave të njeriut, këto agjenci i ekspozohen rrezikut – në aspektin e reputacionit, atë financiar, politik dhe juridik – për shkak të mbështetjes së çfarëdo dëmi, ndërsa mund edhe t'i rrisin sfidat lidhur me të drejtat e njeriut me të cilat ballafaqohet shteti – pranues.

Duke i pasur parasysh këto rreziqe, shtetet duhet të stimulojnë, ndërsa aty ku është e

përshtatshme edhe të kërkojnë, si prej vetë agjencive ashtu edhe prej ndërmarrjeve afariste apo projekteve të cilat i mbështesin, të bëjnë analiza të thella për të drejtat e njeriut. Kërkesa për analizë të thellë për të drejtat e njeriut është më e dobishme në rastet kur natyra apo konteksti i punës afariste çojnë drejt rrezikut të konsiderueshëm lidhur me të drejtat e njeriut.

- 5. Shtetet duhet të bëjnë mbikëqyrje me qëllim që t'i plotësojnë obligimet e tyre të cilat dalin prej së drejtës ndërkombëtare për të drejta të njeriut gjatë dakordimit të kontratave apo sjelljes së ligjeve sipas të cilave ndërmarrjet afariste do të duhet të ofrojnë shërbime të cilat mund të kenë ndikim ndaj plotësimit të drejtave të njeriut.**

Koment

Shtetet lirohen prej obligimeve të tyre të cilat dalin prej të drejtës ndërkombëtare për të drejta të njeriut kur do t'i privatizojnë sigurimin e shërbimeve të cilat mund të ndikojnë ndaj plotësimit të të drejtave të njeriut. Dështimi i shtetit për të siguruar se ndërmarrjet afariste të cilat sigurojnë shërbime të tilla punojnë në pajtim me obligimet e shtetit lidhur me të drejtat e njeriut mund të çojë drejt pasojave juridike dhe pasojave për prestigjin e vetë shtetit. Që aty, është e domosdoshme shtetet qartë t'i theksojnë pritjet e tyre prej ndërmarrjeve dhe t'i respektojnë të drejtat e njeriut në marrëveshjet relevante për shërbime apo në legjislaturën shtetërore. Shtetet duhet të kujdesen se do të mund të bëjnë mbikëqyrje efektive ndaj aktiviteteve të ndërmarrjeve, duke përfshirë edhe përmes sigurimit të mekanizmave të pavarur përkatës për monitorim dhe llogaridhënie.

- 6. Shtetet duhet ta promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut nga ndërmarrjet afariste me të cilat kanë transaksione komerciale.**

Koment

Shtetet kryejnë transaksione të ndryshme komerciale me ndërmarrjet afariste edhe atë jo vetëm në pikëpamje të furnizimeve. Kjo u jep shteteve – mundësi të veçantë apo kolektive për zhvillimin e vetëdijes për të drejtat e njeriut dhe respektimin e tyre nga këto ndërmarrje, duke përfshirë edhe përmes kushteve të përcaktuara në marrëveshje, me respektimin e obligueshëm të obligimeve relevante në pajtim me të drejtën vendore dhe ndërkombëtare.

MBËSHTETJE E RESPEKTIMIT TË DREJTAVE TË NJERIUT NGA NDËRMARRJET AFARISTE NË ZONA TË GODITURA NGA KONFLIKTI

7. Duke e pasur parasysh atë se rreziku prej keqpërdorimeve serioze të të drejtave të njeriut është rritur në sferat e goditura prej konflikteve, shtetet duhet të ndihmojnë në angazhimet që të sigurohet se ndërmarrjet afariste të cilat punojnë në një kontekst të tillë nuk janë të kyçur në keqpërdorime të tilla, përfshirë edhe përmes:
- (a) Angazhimit në fazën më të re të mundshme me ndërmarrjet afariste që t'u ndihmohet t'i identifikojnë, t'i parandalojnë dhe t'i zvogëlojnë rreziqet për të drejtat e njeriut, lidhur me aktivitetet e tyre dhe marrëdhëniet afariste;
 - (b) Ofrimit të mbështetjes përkatëse për ndërmarrjet afariste që të vlerësojnë dhe t'u përgjigjen rreziqeve të rritura prej keqpërdorimit, me kujdes të veçantë në dhunën gjinore dhe seksuale;
 - (c) Refuzimit të qasjes publike dhe shërbimeve për ndërmarrjet afariste të cilat janë të përfshira në keqpërdorime serioze të të drejtave të njeriut dhe refuzojnë bashkëpunim për ballafaqim me situatën;
 - (ç) Sigurimit se politikat e ndërmarra në vazhdimësi, ligjet, rregullativat dhe masat për zbatim janë efektive lidhur me ballafaqimin me rrezikun për involvimin e ndërmarrjeve afariste në keqpërdorimet serioze të të drejtave të njeriut.

Koment

Disa prej shkeljeve më të rënda të të drejtave të njeriut në të cilat janë të involvuara edhe ndërmarrjet afariste ndodhin gjatë konflikteve për kontrollin e ndonjë territori, resurseve ose mbi vetë pushtetin, me ç'rast nuk mund të pritet funksionim i drejtë i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ndërmarrjet afariste përgjegjëse gjithnjë e më shumë kërkojnë udhëzime prej shtetit se si ta mënjanojnë atë që vetë të kontribuojnë drejt shkeljes së të drejtave të njeriut në kontekste të tilla të ndërlikuara. Nevojiten qasje inovative dhe praktike. Më konkretisht, është e rëndësishme vëmendja të drejtohet drejt rrezikut prej dhunës seksuale dhe gjinore, të cilat marrin hov veçanërisht gjatë konfliktit. Është e rëndësishme të gjitha shtetet të ballafaqohen me çështjet para se të përkeqësohet situata në terren. Në rajonet e goditura prej konfliktit, shteti-nikoqir mund të mos jetë në gjendje në mënyrë përkatëse t'i mbrojtë të drejtat e njeriut për shkak të mungesës së kontrollit efektiv. Mu për këtë, kudo ku janë përfshirë kompanitë transnacionale, shtetet e tyre amë kanë detyrë t'u ndihmojnë korporatave por edhe shteteve-amë në përpjekjet të sigurojnë se ndërmarrjet afariste nuk janë të përfshira në keqpërdorimet e të drejtave të njeriut, ndërsa shtetet fqinje mund të japin mbështetje të rëndësishme plotësuese.

Me qëllim të arritjes së harmonizimit më të madh të politikave dhe ndihmesës së ndërmarrjeve afariste në situata të tilla, shtetet amë duhet të nxisin bashkëpunim më të afërt midis agjencive të veta zhvillimore, ministrive për politikë të jashtme dhe tregti dhe institucioneve të cilat e financojnë eksportin në kryeqytetet e tyre dhe në ambasadat, si edhe midis këtyre agjencive dhe organeve qeveritare në shtetin-amë; më tej, të zhvillojnë indikatorë për paralajmërim të hershëm të agjencive shtetërore dhe ndërmarrjeve afariste për problemet e mundshme; si edhe të tregojnë për pasojat nëse ndërmarrjet nuk bashkëpunojnë në kushte të tilla, shkurtimin e mundësisë për shërbime apo mbështetje të tillë në të ardhmen.

Shtetet duhet t'i paralajmërojnë ndërmarrjet afariste për rrezikun e rritur prej involvimit në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në zonat e goditura prej konflikteve. Ato duhet të analizojnë se sa politikat e tyre, legjislatura, rregullat dhe masat për zbatim mundësojnë shmangien e këtij rreziku të rritur, duke i përfshirë edhe përmes miratimit të dispozitave për analizë të thellë për të drejtat e njeriut prej ndërmarrjeve. Më pas, shtetet duhet të ndërmarrin masa për t'i eliminuar të gjitha lëshimet e përcaktuara. Kjo mund të përfshijë edhe analizimin e përgjegjësisë qytetare, administrative apo penale të ndërmarrjeve të cilat punojnë ose kanë seli në territorin e tyre dhe/apo juridiksionin, ndërsa të cilat kanë kryer apo kontribuar drejt shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, shtetet duhet t'i shqyrtojnë mundësitë për zbatimin e qasjeve multilaterale për ballafaqim me veprat e tilla si edhe të mbështesin nisma kolektive efektive.

Të gjitha këto masa i plotësojnë obligimet e shtetit të cilat dalin prej së drejtës ndërkombëtare humanitare në situata të ndonjë konflikti të armatosur, si edhe prej të drejtës ndërkombëtare penale.

SIGURON KOHERENCË TË POLITIKAVE

8. **Shtetet duhet të sigurojnë se departamentet qeveritare, agjencitë dhe institucionet e tjera me seli në shtetet të cilat kanë ndikime mbi praktikat afariste, janë të njohuara me dhe i respektojnë obligimet e shtetit lidhur me të drejtat e njeriut gjatë plotësimit të mandateve të tyre përkatëse, duke përfshirë edhe përmes dhënies së informacioneve përkatëse, trajnimeve dhe mbështetjes.**

Koment

Jo gjithmonë ekzistojnë tensione midis obligimeve të shtetit për respektimin e të drejtave të njeriut dhe ligjeve dhe politikave të cilat ata i miratojnë për përcaktimin e praktikës afariste. Megjithatë, përkohësisht, shtetet duhet të sjellin vendime të rënda me të cilat do t'i harmonizonin nevojat e ndryshme shoqërore. Me qëllim që ta arrijnë baraspeshën përkatëse, shtetet duhet të kenë qasje të gjerë në zgjidhjen e çështjeve aktuale lidhur

me të drejtat e njeriut dhe biznesin që të mund të sigurojnë koherencë vertikale dhe horizontale të politikës vendore.

Harmonizimi vertikal i politikave nënkupton se shtetet i kanë politikat e nevojshme, ligjet dhe proceset me ndihmën e së cilave do t'i plotësojnë obligimet e tyre të cilat dalin prej së drejtës ndërkombëtare për të drejta të njeriut. Harmonizimi horizontal, nga ana tjetër, do të thotë se organet dhe agjencitë të cilat ndikojnë mbi praktikën afariste, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivele më të ulëta, duke i përfshirë këtu edhe ato të cilat obligohen me ligjin për shoqëritë tregtare dhe për rregullimin e letrave me vlerë, investimet, kreditimin dhe sigurimin e eksportit, tregtimin dhe punën, janë të njoftuara dhe veprojnë në pajtim me obligimet e qeverive lidhur me të drejtat e njeriut.

- 9. Shtetet duhet të lënë hapësirë përkatëse në politikat vendore për plotësimin e obligimeve të tyre lidhur me të drejtat e njeriut gjatë realizimit të qëllimeve të përcaktuara në politikat afariste me shtetet e tjera apo ndërmarrjet afariste, për shembull përmes marrëveshjeve investuese apo kontratave.**

Koment

Marrëveshjet ekonomike që shtetet i kontraktjnë me shtetet e tjera ose ndërmarrjet afariste - si marrëveshjet dypalëshe të investimeve, marrëveshjet e tregtisë së lirë ose kontratat për projekte investuese - krijojnë mundësi ekonomike për shtetet. Por ato gjithashtu mund të ndikojnë në hapësirën në dispozicion të qeverive në politikat e brendshme. Për shembull, kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare për investime mund të kufizojnë shtetet në lidhje me zbatimin e plotë të legjislacionit të ri për të drejtat e njeriut, apo të rrezikojë të jenë lëndë e arbitrazhit ndërkombëtar detyruës me rastin e zbatimit të këtij legjislacioni. Prandaj, shtetet duhet të sigurojnë që ato do të vazhdojnë të kenë mundësi të përshtatshme politike dhe rregullatore për të mbrojtur të drejtat e njeriut në përputhje me kushtet e këtyre marrëveshjeve, njëherësh duke ua siguruar mbrojtjen e nevojshme investitorëve.

- 10. Shtetet, kur veprojnë si anëtare të institucioneve multilaterale që punojnë me çështje nga sfera e biznesit duhet:**

- (a) Të kërkojnë garanci se këto institucione as nuk do t'i pamundësojnë shtetet në plotësimin e detyrës së tyre për të siguruar mbrojtje, as nuk do t'i parandalojnë ndërmarrjet afariste për t'i plotësuar të drejtat e njeriut;
- (b) Në kuadër të mandatit dhe kompetencave, duhet t'i inkurajojnë institucionet ta promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut në biznes dhe atje ku do të jetë e nevojshme, t'i ndihmojnë shtetet ta plotësojnë obligimin e vet për mbrojtje prej keqpërdorimeve të të drejtave të njeriut prej ndërmarrjeve

afariste, duke përfshirë edhe përmes ndihmës teknike, ndërtimit të kapaciteteve dhe ngritjen e vetëdijes;

- (c) Në bazë të këtyre Parimeve kryesore, të promovojë mirëkuptimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në ballafaqimin me sfidat lidhur me biznesin dhe të drejtat e njeriut.

Koment

Nevojitet përputhshmëri më e madhe e politikave edhe në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë edhe kur shtetet marrin pjesë në institucione multilaterale të cilat merren me çështjet në sferën e biznesit, siç janë institucionet ndërkombëtare tregtare dhe financiare. Shtetet i ruajnë obligimet e tyre në bazë të së drejtës ndërkombëtare për të drejta të njeriut edhe kur marrin pjesë në institucione të tilla.

Përforcimi i kapaciteteve dhe ngritja e vetëdijes përmes institucioneve të tilla mund të luaj rol kyç në ndihmimin e shteteve për t'i plotësuar obligimet e veta për sigurimin e mbrojtjes, midis së kaluarës dhe përmes krijimit të kushteve për këmbimin e informacioneve për sfidat dhe praktikën më të mirë, me çka do të promovoheshin qasje më konsekuente.

Veprimi kolektiv përmes institucioneve multilaterale mund t'u ndihmojë shteteve të sigurojnë rregulla të barabarta të lojës lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut nga ndërmarrjet, por kjo duhet të bëhet në mënyrë që do të nxiten ata të cilët ngecin. Rol kryesor mund të luaj edhe bashkëpunimi midis shteteve, institucioneve multilaterale dhe palëve të tjera të interesuara.

Në këtë pikëpamje, këto Parime kryesore paraqesin pikë të përbashkët referente dhe mund të shërbejnë si bazë të dobishme për arritjen e efektit pozitiv kumulativ, me ç'rast do të merren parasysh rolet përkatëse dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të interesuara.

II. PËRGJEGJËSIA KORPORATIVE PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

A. PARIME KRYESORE

11. Ndërmarrjet afariste duhet t'i respektojnë të drejtat e njeriut. Kjo do të thotë se ato duhet të shmangin çfarëdo shkelje të të drejtave të njeriut ndaj personave të tjerë dhe të ballafaqohen me ndikimin negativ ndaj të drejtave të njeriut në të cilat janë të përfshirë edhe ato.

Koment

Përgjegjësia për t'u respektuar të drejtat e njeriut paraqet normë të përgjithshme të sjelljes së pritshme për të gjitha ndërmarrjet afariste, kudo që punojnë. Ajo ekziston pavarësisht mundësive dhe/apo gatishmërisë së shteteve për t'i plotësuar obligimet lidhur me të drejtat e njeriut dhe nuk i zvogëlon të njëjtat. Ajo ekziston edhe krahas obligimeve për respektimin e ligjeve dhe rregullave kombëtare me të cilat mbrohen të drejtat e njeriut.

Ballafaqimi me ndikimet negative ndaj të drejtave të njeriut kërkon ndërmarrjen e masave adekuate për parandalimin e tyre, zbutjen dhe sipas nevojës, dëmshpërblimin.

Ndërmarrjet afariste mund të ndërmarrin edhe obligime të tjera apo aktivitete me qëllim që të sigurohet mbështetje dhe zhvillim i të drejtave të njeriut, të cilat mund të kontribuojnë drejt plotësimi të të drejtave. Por, me këtë ato nuk mund të kontribuojnë për çfarëdo mosrespektimi të të drejtave të njeriut gjatë punës së tyre.

Ndërmarrjet afariste nuk duhet t'i minojnë aftësitë e shtetit për t'i plotësuar obligimet e tyre lidhur me të drejtat e njeriut, duke e përfshirë edhe ndërmarrjen e aktiviteteve të cilat mund ta dobësojnë integritetin e procedurave gjyqësore.

12. Përgjegjësia e ndërmarrjeve afariste për t'i respektuar të drejtat e njeriut ka të bëjë me të drejtat e njeriut të pranuar ndërkombëtarisht, duke kuptuar së paku ato të drejta të cilat i përmban Karta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe parimet për të drejtat themelore të cilat i përmban Deklarata për parimet kryesore dhe të drejtat e punës të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Koment

Duke e pasur parasysh atë se ndërmarrjet mund të ndikojnë në mënyrë praktike mbi gjithë spektrin e të drejtave të njeriut të përcaktuara ndërkombëtarisht, përgjegjësia e tyre për respektim ka të bëjë me të gjitha të drejtat. Në praktikë, disa të drejta mund

të jenë më të rrezikuara prej të tjerave në disa industri apo rrethana të caktuara, me ç'rast është e nevojshme t'u kushtohet kujdes më i madh. Megjithatë, situatat mund të ndryshojnë, prandaj të gjitha të drejtat e njeriut duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe rishikimit periodik.

Listën autoritative të të drejtave kryesore të njeriut të përcaktuara ndërkombëtarisht e përmban Konventa Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut (të cilën e përbëjnë Deklarata Universale për të drejta të njeriut dhe instrumentet kryesore përmes së cilave ishte kodifikuar ajo: Pakti ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike, Pakti ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore), ndërsa e plotësojnë parimet lidhur me të drejtat themelore të garantuara me tetë konventat themelore të ONP, ashtu siç janë të përcaktuara në Deklaratën për parimet kryesore dhe të drejtat e punës. Këto janë standardet mbi të cilat aktorët e tjerë shoqërorë e vlerësojnë ndikimin e ndërmarrjeve afariste ndaj të drejtave të njeriut. Përgjegjësia e ndërmarrjeve afariste për t'i respektuar të drejtat e njeriut dallon prej çështjeve për përgjegjësi shoqërore dhe zbatimin e së drejtës, të cilat edhe më tej në masë të madhe rregullohen me legjislaturën kombëtare në juridiksionet përkatëse.

Varësisht rrethanave, është e mundur ndërmarrjet afariste të jenë në situatë të marrin parasysh edhe standarde të tjera. Për shembull, ndërmarrjet duhet t'i respektojnë të drejtat e njeriut të cilat u takojnë grupeve të caktuara apo kategorive të popullatës, ndërsa të cilave duhet t'u kushtohet kujdes më i madh, në rast se puna e tyre në mënyrë negative reflektohet ndaj të drejtave të tyre të njeriut. Në këtë drejtim, Kombet e Bashkuara kanë miratuar instrumente plotësuese lidhur me të drejtat e popujve autoktonë, grave, pakicave kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, punëtorëve-emigrantë dhe familjeve të tyre. Krahas kësaj, në situata të konfliktit të armatosur, ndërmarrjet duhet t'i respektojnë standardet e së drejtës humanitare ndërkombëtare.

13. Përgjegjësia për respektimin e të drejtave të njeriut nënkupton se ndërmarrjet afariste:

- (a) Do t'i shmangen shkaktimit apo kontributit ndaj ndikimeve negative mbi të drejtat e njeriut përmes aktiviteteve të tyre dhe do të ballafaqohen me ndikimet e tyre kur të paraqiten;**
- (b) Do të insistojë t'i parandalojnë apo t'i zvogëlojnë ndikimet negative ndaj të drejtave të njeriut të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt me punën e tyre, produktet apo shërbimet, ndërsa të cilat dalin prej marrëdhënieve të tyre afariste, madje edhe nëse ato nuk kanë kontribuar për ndikimet e tyre.**

Koment

Ndërmarrjet afariste mund të jenë pjesë e ndikimeve negative ndaj të drejtave të njeriut ose përmes aktiviteteve të tyre ose si rezultat i marrëdhënieve afariste me palë të tjera. Parimi kryesor nr. 19 në mënyrë më të detajuar e elaboron çështjen se si ndërmarrjet afariste duhet të ballafaqohen me situata të tilla. Për qëllimet e Parimeve kryesore, nën "aktivitete" të një ndërmarrje afariste nënkuptohen edhe veprimet edhe lëshimet, ndërsa nën "marrëdhënie afariste" nënkuptohen lidhjet me partnerët afaristë, subjektet në zinxhirin e vlerave dhe të gjitha subjektet e tjera joshitetore apo shtetërore të cilat drejtpërdrejt lidhen me punën e saj afariste, produktet dhe shërbimet.

- 14. Përgjegjësia e ndërmarrjeve afariste për t'i respektuar të drejtat e njeriut ka të bëjë me të gjitha ndërmarrjet pavarësisht madhësisë së tyre, sektorit, kontekstit në të cilin punojnë, pronësisë dhe strukturës. Krahas kësaj, madhësia dhe ndërlikueshmëria e mjeteve përmes së cilave ndërmarrjet i plotësojnë obligimet e tyre mund të ndryshojnë varësisht prej këtyre faktorëve dhe seriozitetit të ndikimeve negative që puna e ndërmarrjes e ka ndaj të drejtave të njeriut.**

Koment

Mjetet me të cilat ndërmarrja afariste e plotëson përgjegjësinë e saj për t'i respektuar të drejtat e njeriut duhet, midis tjerash, të jenë proporcionale me madhësinë e saj. Në krahasim me kompanitë më të mëdha, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të kenë kapacitete më të vogla dhe më pak procedura formale dhe struktura administrative, kështu që politikatat e tyre dhe procedurat mund të kenë forma të ndryshme. Por, disa ndërmarrje të vogla dhe të mesme mund të kenë ndikim të madh negativ ndaj të drejtave të njeriut, që tërheq zbatimin e masave përkatëse pavarësisht madhësisë së tyre. Serioziteti i ndikimit do të vlerësohet sipas përmasave të tij, vëllimit dhe (pa)mundësisë për përmirësim. Mjetet përmes të cilave ndërmarrja afariste e plotëson përgjegjësinë e vet lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut mund të dallojnë edhe në varësi prej asaj nëse dhe në çfarë mase puna e saj afariste zhvillohet përmes grupacioneve korporative apo në mënyrë të pavarur. Por, përgjegjësia për t'u respektuar të drejtat e njeriut ka të bëjë në tërësi dhe në mënyrë të veçantë me të gjitha ndërmarrjet afariste.

- 15. Me qëllim që ta plotësojnë obligimin tyre për respektimin e të drejtave të njeriut, ndërmarrjet afariste duhet të kenë të vendosura politika dhe procese të cilat janë përkatëse ndaj madhësisë dhe rrethanave të tyre, të cilat përfshijnë:**
- (a) Obligimin për t'i respektuar të drejtat e njeriut të përcaktuar në politikatat e tyre;
 - (b) Procedurë për analizë të thellë lidhur me të drejtat e njeriut, e cila mundëson identifikimin, parandalimin, zvogëlimin dhe bartjen e përgjegjësisë për ndikimin e tyre ndaj të drejtave të njeriut;

- (c) **Procese të cilat do të mundësojnë dëmshpërblimin e cilitdo ndikim negativ ndaj të drejtave të njeriut të cilën ato e shkaktojnë ose ndaj së cilës kontribuojnë.**

Koment

Ndërmarrjet afariste duhet të dinë dhe të tregojnë se i respektojnë të drejtat e njeriut. Ato nuk mund ta bëjnë atë nëse nuk kanë miratuar politika konkrete dhe nëse nuk kanë vendosur procedura përkatëse. Parimet nr.16-24 në mënyrë më të detajuar e elaborojnë këtë çështje.

B. PARIME OPERATIVE

OBLIGIME TË VENDOSURA ME POLITIKAT

- 16. Me qëllim të "instalimit" të obligimit për respektimin e të drejtave të njeriut, ndërmarrjet afariste duhet ta shprehin përkushtimin e tyre drejt plotësimit të këtij obligimi përmes deklaratës së përmbajtur në politikat e tyre e cila:**
- (a) **Është e miratuar prej nivelit më të lartë në ndërmarrjen afariste;**
 - (b) **Është sjellë përmes konsultimeve të ekspertizës relevante të brendshme dhe/ apo të jashtme;**
 - (c) **I përcakton pritjet lidhur me të drejtat e njeriut të ndërmarrjes nga ana e personelit, partnerët afaristë dhe palët e tjera të cilat lidhen me punën e tij, produktet apo shërbimet;**
 - (ç) **Ka qasje në mënyrë publike apo është kumtuar në mënyrë publike, brenda dhe jashtë kornizave të ndërmarrjes, deri tek i gjithë personeli, partnerët afaristë dhe palët e tjera relevante;**
 - (d) **Përmbahet në politikat operative dhe procedurat e domosdoshme për vendosjen e saj në kornizë të së gjithë ndërmarrjes afariste.**

Koment

Termi "deklaratë" përdoret në mënyrë gjenerike që të përshkruhen të gjitha mjetet të cilat i shfrytëzon ndërmarrja që në mënyrë publike t'i ekspozojë obligimet, angazhimet dhe pritjet e veta.

Niveli i ekspertizës që është e nevojshme të sigurohet se deklarata për politikën është përkatëse dhe gjithëpërfshirëse, do të varet prej ndërlikueshmërisë së punës afariste

të ndërmarrjes. Ekspertiza mund të vijë drejt burimeve të ndryshme, duke filluar prej burimeve të besueshme elektronike apo të shkruara e deri tek konsultimet me ekspertë të shquar.

Deklarata për përkushtim duhet të ketë qasje publikisht. Ajo duhet në mënyrë aktive t'u kumtohet subjekteve me të cilat ndërmarrja ka marrëdhënie dakorduese; me ato të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të lidhura me punën e saj, si për shembull, forcat shtetërore të sigurisë; investitorët; dhe në rast të punës me rreziqe të konsiderueshme për të drejtat e njeriut, me të gjitha palët e involvuara potenciale.

Kumtimi i brendshëm i deklaratës dhe e politikave dhe procedurave të ngjashme duhet në mënyrë të qartë të tregojnë se cilat do të jenë nivelet dhe sistemet e llogaridhënies dhe duhet të shoqërohet me trajnim të domosdoshëm të personelit të funksioneve relevante afariste.

Ashtu siç duhet të punojnë shtetet në koherencën e politikës së tyre, ashtu duhet ndërmarrjet afariste duhet të synojnë drejt arritjes së koherencës midis përgjegjësisë së tyre për t'i respektuar të drejtat e njeriut dhe politikat dhe procedurat me të cilat rregullohen aktivitetet dhe marrëdhëniet e tyre me të gjera afariste. Kjo i përfshin për shembull edhe politikat edhe procedurat për stimulimin financiar apo të ndonjë lloji tjetër të të punësuarve; procedurat për furnizim dhe aktivitetet për lobim atje ku preken të drejtat e njeriut.

Përmes këtyre dhe mjeteve dhe mjeteve të tjera përkatëse, deklaratat për politikat duhet të vihen në nivelet më të larta të ndërmarrjes afariste e deri tek të gjitha pjesët e saj, të cilat do të mund të vepronin pa vetëdije ose konsideratë për të drejtat e njeriut.

ANALIZË E THELLË LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT

17. Me qëllim që të identifikohet, parandalohet, zvogëlohet apo ngritet përgjegjësia për ndikimin negativ ndaj të drejtave të njeriut, ndërmarrjet afariste duhet të bëjnë analizë të thellë lidhur me të drejtat e njeriut. Procesi duhet të përfshijë vlerësimin e ndikimit real dhe potencial ndaj të drejtave të njeriut, integrimin dhe veprimin për konstatimet, ndjekjen e reagimeve dhe informimin për hapat e ndërmarrja. Analiza e thellë lidhur me të drejtat e njeriut:

- (a) Duhet ta përfshijë ndikimin negativ ndaj të drejtave të njeriut që ndërmarrjet afariste mund t'i bëjnë ose ta ndihmojnë përmes aktiviteteve të tyre ose e cila mundet drejtpërdrejt të lidhet me punën e tyre, produktet, shërbimet apo marrëdhëniet e tyre;
- (b) Do të dallojë në ndërlikueshmëri varësisht prej madhësisë së ndërmarrjes, rrezikut prej ndikimit serioz ndaj të drejtave të njeriut si edhe prej natyrës dhe kontekstit të punës së saj;

- (c) Duhet të zbatohet në vazhdimësi, duke e pasur parasysh faktin se rreziqet për të drejtat e njeriut mund të ndryshojnë me kohë siç ndryshon edhe puna edhe konteksti në të cilin punon ndërmarrja.**

Koment

Ky parim i përkufizon parametrat për analizën e thellë lidhur me të drejtat e njeriut, ndërsa, nga ana tjetër, parimet nr. 18-21 në mënyrë detajuese i sqarojnë komponentët e saj kryesore.

Nën rreziqet për të drejtat e njeriut nënkuptohen ndikimet potenciale negative ndaj të drejtave të njeriut të shkaktuara prej ndërmarrjes afariste. Ndikimeve potenciale duhet t'u përgjigjet përmes parandalimit apo zbutjes, ndërsa ndikimet reale – ato të cilat veç më kanë ndodhur – duhet të jenë lëndë e dëshmpërblimit (parimi 22).

Analiza e thellë lidhur me të drejtat e njeriut mund të përfshihet në sistemet më të gjera për menaxhim me rreziqet e ndërmarrjes, nëse ajo nuk kufizohet vetëm në identifikimin dhe menaxhimin me rreziqet materiale për vetë ndërmarrjen dhe i përfshin edhe rreziqet për ata që i gëzojnë të drejtat.

Analiza e thellë lidhur me të drejtat e njeriut duhet të iniciohet në fazën më të hershme të mundshme të zhvillimit të çdo aktiviteti të ri ose marrëdhënie, duke e pasur parasysh se rreziqet për të drejtat e njeriut mund të rriten apo të zvogëlohen që në fazën e strukturimit të marrëveshjeve apo kontratave të tjera, si edhe të trashëgohen përmes bashkimit apo ndërmarrjes.

Gjithmonë kur zinxhiri i vlerave të ndërmarrjes përfshin një numër të madh subjektsh, do të jetë më e vështirë të zbatohet analiza e thellë lidhur me ndikimin potencial negativ ndaj të drejtave të njeriut në të gjitha prej tyre. Në këtë rast, ndërmarrjet afariste duhet të identifikojnë sfera të përgjithshme ku rreziku prej ndikimit negativ ndaj të drejtave të njeriut është i madh, qoftë për shkak të kontekstit në të cilin punon ndonjëri prej furnizuesve apo klientëve, punës konkrete, produkteve dhe shërbimeve të përfshira apo faktorëve të tjerë relevantë dhe ta përcaktojë prioritetin e tyre nga aspekti i analizës së thellë lidhur me të drejtat e njeriut.

Kur ndërmarrja afariste kontribuon ose nuk beson se kontribuon drejt ndikimit negativ ndaj të drejtave të njeriut të shkaktuar prej palëve të tjera, mund të hapen çështje për bashkëpjesëmarrjen e saj. Bashkëpjesëmarrja ka kuptim joligjor dhe ligjor. Si çështje prej natyrës joligjore, ndërmarrja afariste mund të perceptohet si “pjesëmarrëse” në aktivitetet e palës tjetër ku, për shembull mund të përcaktohet dobia potenciale prej keqpërdorimit të cilin e ka bërë ajo palë.

Në aspektin juridik, pjesa më e madhe e juridiksioneve kombëtare e ndalojnë pjesëmarrjen në kryerjen e veprës penale, ndërsa një pjesë e tyre parashohin edhe përgjegjësinë penale për ndërmarrjet afariste në rastet e tilla. Zakonisht, procedurat

qytetare mund të ngriten për shkak të gjoja kontributit të ndërmarrjes drejt shkaktimit të dëmit, që nuk do të thotë se ato gjithmonë janë formuluar përmes prizmit të të drejtave të njeriut. Praktika gjyqësore në të drejtën penale ndërkombëtare tregon se bashkëpjesëmarrja dhe ndihmesa nënkuptojnë ofrimin e vetëdijshëm të ndihmës praktike apo nxitjes që ka pasur ndikim të konsiderueshëm ndaj zbatimit të veprës penale. Zbatimi i analizës së thellë lidhur me të drejtat e njeriut duhet t'u ndihmojë ndërmarrjeve afariste që ta zvogëlojnë rrezikun prej kërkesave juridike të ngritura kundër tyre, me atë që do të tregojnë se i kanë ndërmarrë të gjitha hapa e matura që ta shmangin involvimin në shkeljet e të drejtave të njeriut. Por, ndërmarrjet afariste të cilat zbatojnë analiza të tilla të thella nuk duhet të supozojnë se me atë në mënyrë automatike dhe në mënyrë të plotë do të lirohen prej përgjegjësisë për shkeljen apo kontributin drejt shkeljes së të drejtave të njeriut.

- 18. Me qëllim që të bëhet vlerësimi i rreziqeve lidhur me të drejtat e njeriut, ndërmarrjet afariste duhet ta identifikojnë dhe ta vlerësojnë ndikimin e tyre konkret apo të mundshëm negativ ndaj të drejtave të njeriut në të cilin mund të kyçen përmes aktiviteteve të tyre ose si rezultat i marrëdhënieve të tyre afariste. Ky proces duhet të:**
- (a) Bazohet në ekspertizë të brendshme dhe/apo të jashtme për të drejtat e njeriut;
 - (b) Konsultime të rëndësishme me grupe potenciale të goditura dhe faktorë të tjerë relevantë, në përputhje me madhësinë e ndërmarrjes afariste dhe natyrën dhe kontekstin e punës së saj.

Koment

Hapi i parë në kryerjen e një analize të thellë të të drejtave të njeriut është përcaktimi dhe vlerësimi i natyrës së ndikimeve konkrete dhe të mundshme negative mbi të drejtat e njeriut në të cilat një ndërmarrje mund të përfshihet. Qëllimi i këtij hapi është të kuptohet ndikimi konkret mbi njerëzit në kontekstin e dhënë të punës afariste. Kjo zakonisht nënkupton vlerësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut përpara se të merren aktivitetet e propozuara afariste, nëse është e mundur; përcaktimi i personave që mund të rrezikohen; përpilimi i një liste të standardeve relevante dhe çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut; dhe parashikimi i aktiviteteve të propozuara dhe marrëdhënieve të lidhura me biznesin mund të kenë një ndikim negativ në të drejtat e njeriut për të cilat është përcaktuar se mund të jenë të rrezikuara. Më pas ndërmarrjet duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha ndikimeve

konkrete ndaj të drejtave të njeriut të individëve të cilët u takojnë grupeve apo kategorive konkrete të popullatës, ndërsa të cilat i ekspozohen një rreziku më të madh të ndjeshmërisë apo marginalizimit si edhe t'i kenë parasysh rreziqet e ndryshme me të cilat ballafaqohen gratë dhe burrat.

Proceset për vlerësimin ndaj të drejtave të njeriut mund të jenë pjesë përbërëse prej procedurave të tjera, siç janë procedurat për vlerësimin e rrezikut apo ndikimit ndaj mjedisit jetësor apo shoqërisë, por në çdo rast si pikë nisëse duhet t'i përfshijnë të gjitha të drejtat e njeriut të pranura ndërkombëtarisht pasi ndërmarrjet afariste praktikisht mund të kenë ndikim potencial në të gjitha këto të drejta.

Duke e pasur parasysh dinamikën me të cilën ndryshon gjendja me të drejtat e njeriut, vlerësimet për ndikimin ndaj tyre duhet të kryhen në intervale të rregullta kohore: para filimit të aktiviteteve të reja apo marrëdhënieve; para sjelljes së vendimeve të mëdha apo zbatimit të ndryshimeve serioze në punën afariste (për shembull, para hysjes në një treg të caktuar, pasimit të produktit të ri, ndryshimin e politikës apo ndryshimeve më të mëdha të cilat ndikojnë ndaj ndërmarrjes); në pritje apo si përgjigje ndaj ndryshimeve në rrethimin afarist (për shembull, tensione të rritura në shoqëri) dhe në mënyrë periodike gjatë gjithë aktivitetit apo marrëdhënies.

Që ndërmarrjet të mundën saktësisht ta vlerësojnë ndikimin e tyre ndaj të drejtave të njeriut, ato duhet të insistojnë që ta kuptojnë brengosjen e palëve të involvuara potenciale kështu që në mënyrë të drejtpërdrejtë do t'i konsultojnë, duke i marrë parasysh pengesat gjuhësore dhe të tjera potenciale për veprim efektiv. Në situata ku konsultimet e tilla janë të pamundshme, ndërmarrjet duhet të kërkojnë alternativa të matura siç janë konsultimi i resurseve kompetente prej profesionistëve të pavarur, duke përfshirë edhe prej mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe përfaqësuesve të tjerë të shoqërisë qytetare.

Vlerësimi për ndikimin ndaj të drejtave të njeriut paraqet bazë për hapat e ardhshëm në zbatimin e analizës së thellë për të drejtat e njeriut.

19. Me qëllim që të parandalohet apo që të zvogëlohet ndikimi ndaj të drejtave të njeriut, ndërmarrjet afariste duhet t'i integrojnë rezultatet e vlerësimeve të tyre për ndikimin në të gjitha funksionet e brendshme relevante dhe proceset dhe të ndërmarrin hapa përkatës.

(a) Integrimi efektiv nënkupton se:

- (i) përgjegjësia për ballafaqimin me ndikimin e tillë është ndarë në nivel dhe funksion përkatës në kuadër të ndërmarrjes afariste ;
- (ii) Sjellja e brendshme e vendimeve, sistemimi i buxhetit dhe proceseve për mbikëqyrje mundësojnë përgjigje efektive ndaj ndikimeve të tilla.

(b) Çfarë do të nënkuptohet nën veprimin përkatës do të varet prej:

- (i) Nëse ndërmarrja afariste shkakton ose kontribuon drejt ndikimit negativ apo nëse është kyçur vetëm për atë që ndikimi lidhet drejtpërdrejt me punën e saj, produktet apo shërbimet të cilat dalin prej marrëdhënieve të saj afariste;
- (ii) Shkallës së aftësisë së tij që të ballafaqohet me ndikimin negativ.

Koment

Integrimi horizontal i rezultateve prej vlerësimit të ndikimit ndaj të drejtave të njeriut në nivel të të gjithë ndërmarrjes afariste mund të jetë efektive vetëm nëse obligimet e ndërmarrjes të cilat dalin prej politikave për të drejta të njeriut janë të vendosura në të gjitha funksionet e saj relevante. Kjo është e domosdoshme që të munden në mënyrë të drejtë të kuptohen dhe të merren parasysh rezultatet prej vlerësimit si edhe të ndërmerren masa përkatëse.

Gjatë vlerësimit të ndikimit ndaj të drejtave të njeriut, ndërmarrjet duhet t'i shqyrtojnë si ndikimet konkrete ashtu edhe ato të mundshme negative. Ndikimet e mundshme duhet të parandalohen apo të zbuten përmes integritit horizontal të rezultateve prej vlerësimit në kuadër të gjithë ndërmarrjes, ndërsa, ndikimet konkrete – ato të cilat ekzistojnë – duhet të jenë lëndë e dëmshpërblimit (Parimi 22).

Kur ndërmarrja afariste të shkaktojë apo mund të shkaktojë ndikim negativ ndaj të drejtave të njeriut, atëherë duhet t'i ndërmarrë hapat e domosdoshëm me qëllim të ndalimit apo parandalimit të tyre dhe t'i shfrytëzojë kapacitetet e veta që t'i zbusë pasojat sa është e mundur. Vlerësohet se ndërmarrja ka kapacitete të tilla nëse mund të shkaktojë ndryshime në praktikat e gabuara të subjekteve të cilat shkaktojnë dëm.

Situata është më e komplikuar kur ndërmarrja nuk ka kontribuar në ndikim negativ ndaj të drejtave të njeriut, por megjithatë ky ndikim është drejtpërdrejt i lidhur me punën e saj afariste, produktet dhe shërbimet që dalin nga marrëdhëniet e saj të biznesit me një subjekt tjetër. Faktorë të cilët merren parasysh gjatë përzgjedhjes së masave përkatëse në situatat e tilla janë kapacitetet të cilat ndërmarrja i ka në dispozicion lidhur me subjektin që është lëndë, sa ka rëndësi kjo marrëdhënie për ndërmarrjen, serioziteti i shkeljes si edhe ajo nëse ndërprerja e marrëdhënieve me këtë subjekt do të kishte pasojat negative për të drejtat e njeriut.

Sa më e ndërlikuar të jetë situata dhe ndikimi i saj ndaj të drejtave të njeriut aq më shumë arsye ekzistojnë që ndërmarrja të kërkojë këshillë prej profesionistëve të pavarur gjatë vendosjes për mënyrën në të cilën do të përgjigjet ndaj të njëjtave.

Nëse ndërmarrja disponon me kapacitete për parandalimin apo zbutjen e ndikimit negativ, ajo duhet t'i shfrytëzojë. Nëse nuk ka kapacitete të tilla të mjaftueshme, duhet të

shqyrtojë mënyra të mundshme për përforcimin e tyre. Ndërmarrja mund t'i përforcojë këto kapacitete në mënyrë që subjektit të involvuar do t'i ofrojë mundësi për përforcimin e kapacitetve të tij apo ndonjë simulim tjetër, kështu që do të bashkëpunojë me faktorë të tjerë.

Ekzistojnë situata ku ndërmarrja nuk ka kapacitete të mjaftueshme për ta parandaluar apo për ta zbutur ndikimin negativ ndaj të drejtave të njeriut e as ka mundësi t'i përforcojë. Në një situatë të tillë, ndërmarrja duhet ta shqyrtojë mundësinë për shkëputjen e marrëdhënieve me subjektin, me ç'rast duhet t'i marrë parasysh vlerësimet relevante të ndikimit negativ potencial që kjo procedurë mund ta ketë ndaj të drejtave të njeriut. Kur marrëdhënia është me "rëndësi kyçe" për ndërmarrjen, ndërprerja e saj do të sjellë sfida të reja. Një marrëdhënie e caktuar mund të vlerësohet kyçe nëse rezulton me produkt apo ndonjë shërbim tjetër i cili është i domosdoshëm për punën afariste të ndërmarrjes, ndërsa për të cilat nuk ekziston burim alternativ i matur. Në raste të tilla, duhet të merret parasysh edhe serioziteti i ndikimit ndaj të drejtave të njeriut; sa më serioze është shkelja, aq më shpejtë ndërmarrja do të duhet të ndërmarrë hapa para se të sjellë vendim për qëllimin e ndërprerjes së marrëdhënieve. Për çdo rast, ndërmarrja e cila nuk do t'i ndërpresë marrëdhëniet afariste me subjektin i cili do t'i shkel të drejtat e njeriut, duhet të mund t'i dëshmojë angazhimet e veta të vazhdueshme me qëllim të zbutjes së ndikimit ndaj shkeljes së tillë, si dhe të jetë e gatshme t'i pranojë të gjitha pasojat prej vazhdimit të kësaj marrëdhënie – si ato financiare dhe juridike ashtu edhe pasojat për prestigjin e tij.

20. Me qëllim që të përcaktojnë nëse ndërmarrin aktivitete përkatëse për ballafaqim me ndikimin negativ ndaj të drejtave të njeriut, ndërmarrjet afariste duhet ta monitorojnë efektivitetin e hapave të ndërmarrë. Monitorimi duhet:

- (a) Të bazohet në tregues përkatës cilësorë dhe sasiorë;
- (b) Të bazohet në informacione të kthyeshme të marra edhe prej burimeve të brendshme edhe prej burimeve të jashtme, duke i përfshirë këtu palët e involvuara.

Koment

Monitorimi është i domosdoshëm që ndërmarrja të informohet nëse politikat e saj për të drejta të njeriut zbatohen në mënyrën më të mirë të mundshme, nëse ka vepruar në mënyrë të dobishme në ndikimin e përcaktuar ndaj të drejtave të njeriut, si edhe për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm.

Ndërmarrjet afariste duhet të investojnë angazhime të veçanta në monitorimin e efektivitetit të masave të veta për ndikimet ndaj të drejtave të njeriut dhe individëve prej grupeve apo kategorive të caktuara të popullatës të cilët i janë ekspozuar rrezikut të madh të ndjeshmërisë apo marginalizimit.

Monitorimi duhet të integrohet në proceset përkatëse të brendshme për raportim. Ndërmarrjet afariste duhet t'i shfrytëzojnë veglat të cilat tashmë shfrytëzohen për çështje të tjera. Këto vegla mund t'i përfshijnë marrëveshjet për angazhim dhe vlerësimet e punës si edhe anketat dhe revizionet, me zbatimin e të dhënave për gjininë aty ku është relevante. Edhe mekanizmat për parashtrimin e ankesës në nivel operativ mund të japin informacione të konsiderueshme kthesë për efektivitetin e analizës së thellë të ndërmarrjes për të drejtat e njeriut të siguruara prej atyre të cilët janë të goditur drejtpërdrejt (shiko Parimin 29).

- 21. Me qëllim që të sigurojnë llogaridhënie lidhur me ballafaqimin me ndikimin e vet ndaj të drejtave të njeriut, ndërmarrjet afariste duhet të përgatiten një gjë të tillë ta kumtojnë në mënyrë të jashtme, veçanërisht kur është shprehur brengosje prej apo në emër të palëve të involvuara. Ndërmarrjet afariste puna e së cilave apo mjedisi i punës sjell rreziqe prej ndikimit serioz ndaj të drejtave të njeriut, duhet në mënyrë formale të raportojnë se si ballafaqohem me to. Në çdo rast, komunikimi duhet të:**
- (a) Jetë në formë dhe interval të cilat do ta reflektojnë ndikimin e ndërmarrjes ndaj të drejtave të njeriut dhe e cila do të jetë në dispozicion për publikun e targetuar;**
 - (b) Sigurojë informacione të mjaftueshme që të mund të vlerësohet përshtatshmëria e përgjigjes së ndërmarrjes në ndonjë lidhje konkrete me ndikim të përcaktuar ndaj të drejtave të njeriut;**
 - (c) Për kthim, nuk sjell rrezik për palët e involvuara, personelin apo për kërkesat legjitime për besueshmëri në punën komerciale.**

Koment

Obligimi i ndërmarrjeve për t'i respektuar të drejtat e njeriut nënkupton miratimin e politikave dhe proceseve përmes së cilave, nga njëra anë, ato do të njoftohen, ndërsa nga ana tjetër, do të tregojnë se si i respektojnë të drejtat e njeriut në praktikë. Kjo e përfshin edhe publikimin e informacioneve me çka sigurohet edhe një shkallë e caktuar e transparencës dhe përgjegjësisë ndaj individit dhe grupeve të cilat mund të goditen, si edhe ndaj palëve të tjera të involvuara relevante, duke i përfshirë edhe investitorët. Komunikimi mund të realizohet në forma të ndryshme, duke i përfshirë këtu edhe

takimet personale, dialogun përmes internetit, konsultimet me palët e involvuara si edhe përmes shtrimit të raporteve formale publikisht. Raportimi formal edhe vetë mund të evoluojë, kështu raportet e rregullta vjetore dhe raportet për përgjegjësi/qëndrueshmëri korporative mund të përbëjnë dhe azhurnojnë të dhëna të qasshme në internet dhe raporte të integruara financiare dhe jofinanciare.

Nga ndërmarrjet pritet të dorëzojnë raporte financiare në raste rreziku prej ndikimit negativ serioz ndaj të drejtave të njeriut, pavarësisht nëse arsyet qëndrojnë në natyrën e punës së tyre afariste ose në kontekstin ku punojnë. Raporti duhet t'i përfshijë edhe temat dhe treguesit të cilët tregojnë se si ndërmarrja e përcakton dhe ballafaqohet me ndikimin negativ ndaj të drejtave të njeriut. Kontrolli i pavarur i raporteve për respektimin e të drejtave të njeriut mund të kontribuojë drejt përmirësimit të përmbajtjes së tyre dhe besueshmërisë. Treguesit për sektorë konkretë mund të jenë edhe burim i dobishëm për informacione plotësuese.

KOMPENSIMI

22. Aty ku kanë identifikuar se kanë shkaktuar apo kontribuar për ndikim negativ, ndërmarrjet afariste duhet të sigurojnë apo bashkëpunojnë me qëllim që të sigurohet kompensim përmes proceseve legjitime.

Koment

Madje edhe ndërmarrjet me politikat dhe praktikat më të mira mund të shkaktojnë apo kontribuojnë drejt ndikimit negativ ndaj të drejtave të njeriut të cilën nuk e kanë paraparë apo nuk kanë pasur mundësi ta parashohin.

Kur çdo ndërmarrje afariste do të identifikojë një situatë të tillë, pavarësisht nëse ajo është në kuadër të procesit për zbatimin e analizës së thellë për të drejtat e njeriut apo në ndonjë mënyrë tjetër, obligimi i saj për t'i respektuar të drejtat e njeriut nënkupton pjesëmarrje aktive në procedurën për dëmshpërblim, në mënyrë të pavarur apo në bashkëpunim edhe me faktorë të tjerë. Mekanizmat për ankesë në nivel operativ mund të paraqesin mjet efektiv për ata të cilët ndoshta janë të rrezikuar me aktivitetet e ndërmarrjes afariste nga aspekti i mundësimit të dëmshpërblimit, me kusht që t'i plotësojnë disa kriteret e caktuara bazë nga aspekti i mundësimit të dëmshpërblimit, me kusht që t'i plotësojnë disa kriteret e caktuara bazë, siç është theksuar në Parimin 31. Në rast të ndikimit negativ të cilin nuk e ka shkaktuar apo ndaj së cilit nuk ka kontribuar ndërmarrja, por që lidhet drejtpërdrejt me punën e tij afariste, produktet apo shërbimet në bazë të një marrëdhënie afariste, obligimit për respektimin e të drejtave të njeriut nuk sjell obligim për ndërmarrjet që vetë të sigurojnë dëmshpërblim, edhe pse ato mund ta kenë rolin e tyre në atë.

Në disa situata të caktuara, veçanërisht ku ekzistojnë baza për vepra kriminale, sipas rregullit, duhet bashkëpunim me mekanizmat gjyqësore.

Udhëzime më të detajuara për mekanizmat përmes së cilave palët e rrezikuara mund të kërkojnë dëmshpërblim, duke i përfshirë edhe për rastet ku kontestohen pretendimet për ndikimin negativ ndaj të drejtave të njeriut, janë paraqitur në Kapitullin III për qasje deri tek mjetet juridike .

PYETJE LIDHUR ME KONTEKSTIN

23. Në të gjitha kontekstet, ndërmarrjet afariste duhet të :

- (a) Respektojnë të gjitha ligjet në fuqi dhe të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht, kudo që veprojnë;**
- (b) Gjejnë mënyra për respektimin e parimeve lidhur me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht në raste të kërkesave të kundërshtuara;**
- (c) E trajtojnë rrezikun prej shkakut apo kontributit drejt keqpërdorimeve serioze të të drejtave të njeriut si çështje për harmonizim juridik, kudo ku veprojnë.**

Koment

Edhe pse konteksti apo mjedisi lokal mund të ndikojnë mbi rrezikun për të drejtat e njeriut i shkakuar prej aktiviteteve apo marrëdhënieve afariste të ndonjë ndërmarrje, megjithatë të gjitha ndërmarrjet kanë obligim të njëjtë – t'i respektojnë të drejtat e njeriut kudo ku kryejnë aktivitete afariste. Në rastet ku konteksti lokal e pamundëson plotësimin e të gjitha obligimeve në tërësi, nga ndërmarrja pritet t'i respektojnë parimet e të drejtave të njeriut të pranuar në nivel ndërkombëtar në masë të madhe në rrethanat e dhëna dhe të jenë në gjendje t'i tregojnë angazhimet e tyre në këtë drejtim.

Rreziku nga pjesëmarrja në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të cilat i bëjnë faktorë të tjerë (për shembull, forcat e sigurisë) rritet në disa rrethime afariste, siç janë zonat e goditura prej përlëshjeve. Ndërmarrjet e tilla duhet ta trajtojnë këtë rrezik si çështje e harmonizimit juridik, duke e pasur parasysh përgjegjësinë korporative juridike potenciale që del prej padive qytetare eksteritoriale si dhe prej dispozitave të Statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtare në juridiksione ku përcaktohet përgjegjësia penale korporative. Krahas kësaj, drejtorët, drejtuesit dhe të punësuarit mund të thirren personalisht për përgjegjësi për procedura që paraqesin shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.

Në kontekste të tilla të ndërlikuara, ndërmarrjet duhet të kenë kujdes të mos e vështirësojnë situatën. Gjatë përzgjedhjes së reagimit më efikas, preferohet të mos

mbështeten vetëm në profesionalitetin dhe konsultimet me reparte të ndryshme në kuadër të ndërmarrjes, por të drejtohen edhe deri tek profesionistët e pavarur të jashtëm, duke i përfshirë edhe ata në qeveritë, shoqërinë qytetare, institucionet kombëtare për të drejta të njeriut dhe nismat relevante multilaterale.

- 24. Aty ku ka nevojë të përcaktohet prioriteti dhe aktivitetet me qëllim të ballafaqimit me ndikimin konkret dhe potencial ndaj të drejtave të njeriut, ndërmarrjet afariste duhet të insistojnë t'i parandalojnë dhe t'i zvogëlojnë ato rreziqe cilat janë më serioze apo ato tek të cilat reagimi i vonuar do të rezultonte me moskompensim.**

Koment

Ndërmarrjet duhet të ballafaqohen me të gjitha ndikimet negative ndaj të drejtave të njeriut, por nuk do të kenë gjithmonë mundësi që atë ta bëjnë në të njëjtën kohë. Nëse detyrohen ta përcaktojnë radhitjen e prioriteteve ndërsa në mungesë të drejtimeve konkrete ligjore, ndërmarrjet duhet të fillojnë me ato ndikime ndaj të drejtave të njeriut të cilat do të ishin më serioze, duke u nisur nga ajo se çdo reagim i vonuar mund të çojë drejt moskompensimit. Në këtë kontekst, serioziteti nuk paraqet koncept absolut, por varet prej ndikimeve të tjera ndaj të drejtave të njeriut të cilat i ka përcaktuar ndërmarrja.

II. QASJE NË MJETET JURIDIKE

A. PARIME KRYESORE

25. Si pjesë e detyrave të tyre për sigurimin e mbrojtjes prej keqpërdorimeve të të drejtave të njeriut lidhur me punën afariste, shtetet duhet të ndërmarrin hapa konkretë që të sigurohen se në rast se ndodhin keqpërdorime të tilla në territorin e tyre dhe/apo në juridiksionin e tyre, ato që janë të goditura prej tyre kanë qasje drejt mjeteve financiare efektive të siguruara përmes mjeteve gjyqësore, administrative, ligjdhënëse apo mjeteve të tjera përkatëse.

Koment

Nëse shtetet nuk i ndërmarrin hapat përkatës për hetimin, ndëshkimin dhe dëmshpërblimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut prej ndërmarrjet afariste, obligimi i tyre për sigurimin e mbrojtjes të të drejtave të njeriut mund të konsiderohet të bëhet jo efkase, madje edhe e pakuptimtë..

Qasja drejt mjeteve juridike efektive ka edhe aspekte materiale por edhe proceso-juridike. Mjetet juridike të cilat janë në dispozicion përmes mekanizmave për ankimim të cilat përfshihen në këtë pjesë mund të kenë një diapazon të tërë të formave materiale qëllimi i së cilave, do të jetë t'i neutralizojnë apo t'i përmirësojnë të gjitha shkeljet e krijuara të të drejtave të njeriut. Mjetet juridike mund të jenë në formë të kërkimfaljeve, restitimit, rehabilitimit, kompensimit financiar apo jofinanciar dhe sanksioneve ndëshkuese (penale apo administrative, siç janë dënimet në të holla), si edhe pengimit të shkeljeve të reja për shembull përmes ndalesave gjyqësore apo garancive për mospërsëritje. Procedurat për sigurimin e mjeteve juridike duhet të jenë të paanshme dhe të mbrojtura prej korrupsionit, si edhe prej formave politike dhe të tjera për ndikim mbi rezultatin e tyre. Për qëllimet e këtyre Parimeve kryesore, me ankesë nënkuptohet padrejtësia e cila ndonjë individ apo grup vlerëson se u është bërë në bazë të ndonjë të drejte të tyre e cila mund të bazohet në ligj, marrëveshje, premtime eksplicite apo implicite, praktikë të zakonshme apo paraqitjet e përgjithshme për barazinë e bashkësisë e cila parashtron ankesë. Termi "mekanizëm ankues" e shënon procedurën e organizuar gjyqësore apo jashtëgjyqësore të cilën e zbaton një organ shtetëror dhe joshetëror, ndërsa përmes së cilës mund të shtrohet ankesë për shkak të shkeljes së të drejtave të njeriut nga ndërmarrjet afariste dhe të kërkohen mjetet juridike.

Mekanizmat shtetërorë për ankimim mund të jenë nën kompetencat e ndonjë departamenti apo agjencie të shtetit apo trupi të pavarur i krijuar në bazë të ligjit dhe kushtetutës. Këto mekanizma mund të jenë gjyqësore dhe jashtëgjyqësore. Më

pas, në disa mekanizma, ankimesit janë të kyçur drejtpërdrejt në kërkesën për mjet financiar, nga ana tjetër tek të tjerët kjo e bën ndërmjetësues në emër të tyre. Këtu, për shembull, bëjnë pjesë gjykatat (penale dhe civile), më tej gjykatat për konteste të punës, institucionet kombëtare për të drejta të njeriut, zyrat kombëtare për kontakt të vendosura në pajtim me Udhëzimet për ndërmarrjet multinacionale të Organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim, zyrat e shumta të avokatëve të popullit dhe shërbimet qeveritare për shqyrtimin e ankesave.

Sigurimi i qasjes drejt mjeteve juridike në rast të shkeljes së të drejtave të njeriut nga ndërmarrja e imponon edhe obligimin e shtetit të punojë në ngritjen e vetëdijes publike dhe mirëkuptimit të këtyre mekanizmave, mënyrat për përdorimin e tyre si edhe ofrimin e çfarëdo lloji të mbështetjes (financiare dhe profesionale) për këtë qëllim.

Mekanizmat shtetërore gjyqësore dhe jashtëgjyqësore duhet të jenë baza e sistemit më të gjerë dhe mjeteve juridike. Në kuadër të një sistemi të tillë, procedurat ankimese në nivel operativ mund të sigurojnë mundësi për parashtrimin e ankesave për zgjidhjen e kontesteve në fazë të hershme. Mekanizmat shtetërore dhe mekanizmat në nivel operativ mund të plotësohet apo përforcohen me funksionet mbrojtëse të nismave për bashkëpunim, si edhe me masat e mekanizmave ndërkombëtare dhe rajonale për të drejta të njeriut. Udhëzime plotësuese lidhur me këto mekanizma janë dhënë në parimet nr. 26-31.

B. PARIME OPERATIVE

MEKANIZMA GJYQËSORE SHTETËRORE

26. Shtetet duhet të ndërmarrin hapa përmes së cilave do të sigurojnë efikasitet për mekanizmat gjyqësore vendore gjatë ballafaqimit me keqpërdorimet e të drejtave të njeriut lidhur me punën afariste, duke e përfshirë edhe përmes shqyrtimit të mënyrave të ndryshme për zvogëlimin e pengesave juridike, praktike dhe të tjera relevante të cilat mund të çojnë drejt pamundësisë të qasjes drejt mjetit financiar.

Koment

Mekanizmat gjyqësore efektive janë kyçe për sigurimin e qasjes drejt mjeteve juridike. Aftësia e tyre për zgjidhjen e kontesteve lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut lidhur me punën afariste varet prej paanshmërisë së tyre, integritetit dhe aftësisë për udhëheqjen përkatëse të procedurave.

Shtetet duhet të kenë kujdes që të mos krijojnë pengesa të cilat do ta pamundësonin dorëzimin e padive legjitime para gjykatave në situata kur veprimi i gjykatës është i domosdoshëm që të fitohet qasje drejt mjetit juridik ose kur nuk ekzistojnë burime alternative për marrjen e mjeteve juridike efektive. Gjithashtu, ato duhet të kujdesen se ndarja e drejtësisë nuk do të pamundësohet prej proceseve gjyqësore të korruptuara, se gjykatat janë të pavarura prej presioneve politike apo ekonomike prej organeve të tjera shtetërore apo prej faktorëve juridikë, si edhe se nuk ekzistojnë pengesa për veprim legjitim dhe të qetë të mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Pengesat juridike të cilat mund t'i pengojnë paditë legjitime lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut lidhur me punën afariste mund të paraqiten për shembull, kur:

- Mënyra në të cilën është shpërndarë përgjegjësia ligjore e pjesëtarëve të grupacioneve korporative sipas së drejtës penale dhe civile vendore mundëson shmangien e përgjegjësisë përkatëse;
- Shtruesit e padive ballafaqohen me privimin e të drejtave të tyre në shtetin – nikoqir dhe nuk kanë qasje në gjykatat në shtetin amë pavarësisht bazës së padisë;
- Disa grupe të caktuara, për shembull, popullata vendore apo emigrantët, nuk e gëzojnë nivelin e njëjtë të mbrojtjes juridike të të drejtave të tyre të njeriut në krahasim me popullatën tjetër.

Pengesat praktike dhe procesuale për qasje në mjetet juridike gjyqësore mund të paraqiten, për shembull, kur:

- Shpenzimet për dorëzimin e ankesave e tejkalojnë vlerën e cila është përkatëse për t'i kthyer shtruesit nga shtrimi i padive të pabaza dhe/apo mund të zvogëlohen deri në nivelin e matur me mbështetjen prej qeverisë, mekanizmave "tregtare" (siç janë sigurimi në rast të procedurave gjyqësore dhe strukturën e shpenzimeve për udhëheqjen e kontestit), apo mjeteve të tjera;
- Shtruesit e padive ballafaqohen me vështirësi gjatë angazhimit të përfaqësuesve juridikë për shkak të mungesës së mjeteve apo mënyrave të tjera përmes së cilave avokatët do të stimulohen që t'i këshillojnë ankuesit e punëve prej kësaj sfere;
- Nuk ekzistojnë mundësi adekuate për bashkimin e ankesave apo për udhëheqjen e procedurave reprezentative (për shembull, shtrimin e padive **grupe dhe procedurave të tjera për shqyrtimin e padive kolektive**, ndërsa me atë pamundësohet qasja drejt mjeteve juridike efikase të ankimuesve individual;

- Prokurorët e shtetit nuk kanë resurse të mjaftueshme, profesionalizim dhe mbështetje për t'i plotësuar obligimet e shtetit vetë ta hetojë involvimin e individëve dhe ndërmarrjeve në vepra penale lidhur me të drejtat e njeriut.

Një pjesë e madhe e këtyre pengesave janë rezultat, apo kombinim i mospërputhjes së pranishme midis palëve në procedurat ankimuese lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut në lidhje me punën afariste, siç janë dallimet në mjetet e tyre financiare, qasja drejt informacioneve dhe njohurive profesionale. Aq më shumë edhe si rezultat i diskriminimit aktiv apo si pasojë e qëllimshme e mënyrës në të cilën janë vendosur dhe funksionojnë mekanizmat gjyqësore, pjesëtarët e disa grupeve apo disa pjesë të popullatës të cilat i janë ekspozuar rrezikut më të madh prej ndjeshmërisë apo marginalizimit, shpesh ballafaqohen me pengesa kulturore, shoqërore, fizike dhe financiare lidhur me qasjen, përdorimin dhe dobinë e këtyre mekanizmave. Vëmendja e veçantë duhet t'u kushtohet të drejtave dhe nevojave specifike të grupeve apo pjesëve të tilla të popullatës në të gjitha fazat e procesit për sigurimin e mjeteve juridike: qasjes, veprimeve dhe rezultatit.

MEKANIZMA JASHTËGJYQËSORE SHTETËRORE PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE

- 27. Krahas mekanizmave gjyqësore, shtetet duhet të mundësojnë edhe mekanizma ankimuese efektive dhe përkatëse jogjyqësore, si pjesë e një sistemi gjithëpërfshirës shtetëror i mjeteve financiare për keqpërdorime të të drejtave të njeriut lidhur me punën afariste.**

Koment

Mekanizmat administrative, ligdhënëse dhe të tjera jashtëgjyqësore luajnë rol kyç në plotësimin e mekanizmave gjyqësore. Madje edhe aty ku sistemet gjyqësore janë efektive dhe disponojnë me resurse të mjaftueshme, ato nuk mundin vetë ta mbajnë të gjithë barën që del prej shqyrtimit të të gjitha keqpërdorimeve të supozuara; mjetet juridike gjyqësore nuk janë gjithmonë të nevojshme dhe jo gjithmonë preferohen prej të gjithë ankimuesve.

Zbrazëtirat në sigurimin e mjetit juridik në rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut me punën efektive mund të plotësohen, aty ku është e përshtatshme, përmes përhapjes së kompetencave të mekanizmave ekzistuese jashtëgjyqësore dhe/apo përmes vendosjes së mekanizmave të reja. Këto mekanizma mund të bazohen në ndërmjetësimin, arbitrazhin apo të zbatojnë procese të tjera të pranueshme kulturore me standardet për të drejtat e njeriut – apo, nga ana tjetër, të paraqesin kombinim të këtyre mekanizmave – varësisht prej çështjeve për të cilat bëhet fjalë, ekzistimit të interesit publik dhe nevojave

potenciale të palëve të ndryshme. Që të jenë efektive, ato duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në parimin 31.

Në këtë kuptim, rol të veçantë luajnë institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Si edhe me mekanizmat gjyqësorë, shtetet duhet të shqyrtojnë mënyra për pabarazi midis palëve në procedura lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut lidhur me punën afariste dhe të gjitha pengesat plotësuese me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e grupeve apo kategorive të popullatës të cilat i ekspozohen rrezikut më të madh të ndjeshmërisë apo marginalizimit.

MEKANIZMA ANKIMUESE JOSHTETËRORE

28. Shtetet duhet të marrin parasysh mënyra të ndryshme me lehtësimin e qasjes drejt mekanizmave ankimuese efektive joshtetërore lidhur me keqpërdorimin e të drejtave të njeriut që dalin prej punës afariste.

Koment

Një prej kategorive të mekanizmave ankimuese joshtetërore i përfshin ato mekanizma të cilat i vendosin ndërmarrjet afariste, vetë apo së bashku me palët e involvuara, ndonjë shoqatë industriale apo ndonjë grup i përbërë prej më shumë palëve të involvuara. Ato paraqesin mekanizma jashtëgjyqësore, por mund të zbatojnë procedura të bazuara në arbitrazh, dialog apo procedura të tjera të pranuar kulturologjike të harmonizuara me standardet për të drejta të njeriut. Këto mekanizma mund të ofrojnë përparësi të veçanta, si për shembull shpejtësi të qasjes dhe remediacionit, shpenzime të zvogëluara dhe/apo mundësi për zgjidhjen e kontesteve transkombëtare .

Një kategori tjetër i përfshin trupat rajonal dhe ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut. Këta trupa zakonisht merren me shkeljen e obligimeve të shteteve për respektimin e të drejtave të njeriut. Megjithatë, disa prej tyre merren me mosplotësimin e obligimeve sipas të cilave shteti duhet të sigurojë qasje prej shkeljeve të të drejtave të njeriut prej ndërmarrjeve afariste.

Shtetet mund të luajnë rol të dobishëm në përforcimin e vetëdijes dhe lehtësimin e qasjes drejt opsioneve të tilla, krahas mekanizmave të cilat ata vetë i sigurojnë.

29. Me qëllim që të mundësohet zgjidhje e hershme dhe e drejtpërdrejt e ankesave, ndërmarrjet afariste duhet të vendosin apo të marrin pjesë në mekanizma ankimuese efektive në nivel operativ për individët dhe për bashkësitë të cilat mund të jenë lëndë e ndikimit negativ.

Koment

Mekanizmat ankimuese në nivel operativ janë në dispozicion drejtpërdrejt për individët dhe për bashkësitë mbi të cilat ndonjë ndërmarrje mund të kryejë ndikim negativ. Zakonisht, me to drejtohen ndërmarrjet, vetë apo në bashkëpunim me të tjerë, duke i përfshirë edhe palët e interesuara relevante. Këto mekanizma mund të sigurohen edhe përmes ofrimit të qasjes ndaj ndonjë personi apo trupi të jashtëm profesional. Më pas, shtruesi i ankesës nuk duhet të shfrytëzojë mjete të tjera për mbrojtje juridike para se të kalojë në shfrytëzimin e këtyre mekanizmave. Ato mund të drejtohen drejtpërdrejt deri tek ndërmarrjet me qëllim që të bëhet vlerësimi i çështjeve dhe të kërkohen masa korigjuese për çdo dëm të krijuar.

Mekanizmat ankimuese në nivel operativ kryejnë dy funksione kryesore lidhur me obligimin e ndërmarrjeve afariste për t'i respektuar të drejtat e njeriut.

- Së pari, ato e mbështesin përcaktimin e ndikimeve negative ndaj të drejtave të njeriut në kuadër të analizës së thellës për të drejta të njeriut që e zbaton ndërmarrja. Atë e bëjnë me atë që sigurojnë kanal përmes së cilit subjektet e rrezikuara drejtpërdrejt prej punës afariste të ndërmarrjes mund ta shprehin brengën e tyre kur vlerësojnë se ekziston apo do të paraqitet ndikimi i ardhshëm negativ. Përmes analizës së trendeve dhe skemave të pranishmit në ankesa, ndërmarrjet afariste mund t'i përcaktojnë edhe problemet sistemore dhe në mënyrë përkatëse e përshtatin punën e tyre.
- Së dyti, këto mekanizma u mundësojnë ndërmarrjeve afariste t'i shqyrtojnë ankesat dhe pasi të përcaktojnë ndonjë keqpërdorim, të veprojnë për to dhe të zbatojnë masa korigjuese që në fazë të hershme, me çka do të parandalohet rritja e dëmeve dhe eskalimi i ankesave.

Mekanizmat e tillë nuk duhet të kërkojnë ankesat të dorëzohen pasi të arrihet një nivel i caktuar i shkeljes të së drejtave të njeriut, por të kenë për qëllim konkret t'i përcaktojnë të gjitha shkaqet legjitime për brengosje të të gjithë atyre që mund të jenë lëndë e ndikimit negativ. Nëse këto shkaqe të brengosjes nuk përcaktohen dhe nuk mënjahohen, me kohë mund të shndërrohen në konteste më të mëdha dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

Mekanizmat ankimuese në nivel operativ duhet t'i plotësojnë disa kriteret e caktuara të cilat do ta sigurojnë efikasitetin e tyre në praktikë (Parimi 31). Këto kriteret mund të plotësohen përmes llojeve të ndryshme të mekanizmave ankimuese varësisht nevojave të cilat kushtëzohen prej përmasave, resurseve, sektorit, kulturës dhe parametrave të tjerë. Mekanizmat ankimuese në nivel operativ munden në mënyrë të dukshme të kontribuojnë

drejt angazhimit më të zgjeruar të palëve të involvuara dhe drejt proceseve për negociim kolektiv, por nuk mund të jenë zëvendësim i tyre. Ato nuk duhet të përdoren për dobësimin e rolit të sindikatave legjitime në zgjidhjen e kontesteve juridike e as për pamundësimin e qasjes drejt mekanizmave ankimese gjyqësore dhe të tjerave jogjyqësore.

- 30. Industria, grupet e palëve të involvuara dhe nismat e tjerë në bashkëpunim të cilat bazohen në respektimin e standardeve për të drejta të njeriut duhet të sigurojnë qasje deri tek mekanizmat ankimese efektiv .**

Koment

Standardet lidhur me të drejtat e njeriut gjithnjë e më shpesh i përmbajnë obligimet të cilat i ndërmarrin trupat industrial, nismat në përbërje të së cilave ka më shumë palë të involvuara, si edhe nisma të tjera për bashkëpunim edhe atë përmes kodeve të sjelljes, standardeve për cilësinë e punës, marrëveshjet kornizë globale midis sindikatave dhe korporatave transkombëtare dhe dokumenteve të ngjashme.

Këto nisma për bashkëpunim duhet të sigurojnë qasje të mekanizmave efektive përmes së cilave palët e rrezikuara apo përfaqësuesit e tyre legjitim do të mund të shprehin brengosje kur vlerësojnë se obligimet lëndë nuk janë plotësuar. Legjitimiteti i nismave të tilla mund të vihet në rrezik nëse ato nuk sigurojnë mekanizma të tillë. Këto mekanizma mund të vihen në nivel të disa anëtarëve individual, në nivel të nismave për bashkëpunim, apo edhe në të dyja nivelet. Ato duhet të mundësojnë llogaridhënie dhe të ndihmojnë në përcaktimin e masave korrigjuese për largimin e ndikimit negativ ndaj të drejtave të njeriut.

KRITERE PËR EFEKTIVITETIN E MEKANIZMAVE ANKIMUESE JOGJYQËSORE

- 31. Me qëllim që të sigurohet efektiviteti i tyre, mekanizmat ankimese jogjyqësore shtetërore dhe joshtetërore duhet të jenë:**
- (a) Legjitime: të krijojnë besim tek grupet e involvuara për të cilat dedikohen dhe të bartin përgjegjësi për zbatimin juridik të procedurave ankimese;
 - (b) Qasëse: t'i njohin të gjitha grupet e palëve të involvuara për të cilat dedikohen dhe të mundësojnë ndihmë përkatëse për ato të cilat mund të ballafaqohen me disa pengesa të caktuara në qasje;

- (c) Të parashikueshme: të sigurojnë procedurë të qartë dhe të njohur me kornizë kohore indikative për çdo fazë, qartësi në lidhje me llojet e proceseve dhe rezultateve në dispozicion si edhe mjetet për ndjekjen e implementimit;
- (ç) Të drejta: të insistojnë palëve të dëmtuara t'u sigurojnë qasje të matur deri tek burimet e informacioneve, këshilla dhe ekspertiza të cilat janë të nevojshme për involvim në procedurën ankimuese nën kushte të drejta, të informuara dhe dinjitoze;
- (d) Transparente: t'i informojnë palët në procedurën ankimuese për progresin dhe të sigurojnë informacione të mjaftueshme për rezultatet e mekanizmit në drejtim të ndërtimit të besimit në efektivitetin e saj dhe plotësimin e cilitdo interes publik të rrezikuar;
- (dh) Kompatabile me të drejtat: të sigurojnë se rezultatet dhe mjetet juridike janë në pajtim me të drejtat e njeriut të pranuar ndërkombëtarisht;
- (e) Burim i mësim të vazhdueshëm: të shfrytëzojnë masa relevante me qëllim që të përcaktohen disa drejtime për përmirësimin e mekanizmit dhe parandalimin e ankesave dhe dëmeve të ardhshme;

Gjithashtu, mekanizmat në nivel operativ duhet të jenë:

- (ë) Të bazuara në komunikim dhe dialog: konsultimin e grupeve të palëve të involvuara për të cilat dedikohen në lidhje me dizajnin dhe funksionimin e tyre dhe fokusimin në dialogun si mjet për veprimin dhe me zgjidhjen e ankesave.

Koment

Mekanizmi ankimues mund ta plotësojë qëllimin e tij vetëm nëse njerëzit të cilëve u dedikohet e dinë se ekziston, kanë besim në të dhe mund ta zbatojnë. Këto kritere paraqesin tregues për ideimin, rishikimin apo vlerësimin e mekanizmave ankimuese jashtëgjyqësore dhe ndihmojnë që të sigurohet efektiviteti i tyre në praktikë. Një mekanizëm ankimues i ideuar keq apo i zbatuar keq mund të çojë drejt thellimit të ndjenjës së pakënaqësisë midis palëve të rrezikuara, duke e përforcuar ndjenjën e tyre të mosrespektimit të procedurës.

Shtatë kriteret e parë kanë të bëjnë me të gjitha mekanizmat shtetërore dhe joshtetërore, si edhe me mekanizmat e bazuara në arbitrazh apo dialog. Kriteri i tetë ka të bëjë konkretisht me mekanizmat në nivel operativ me të cilat drejtohen vetë ndërmarrjet afariste.

Termi "mekanizëm ankimues" këtu përdoret në kuptimin tekniko-juridik. Termi vetvetiu jo

gjithmonë është përkatës apo i dobishëm kur bëhet fjalë për ndonjë mekanizëm konkret, pro kriteret për efektivitet mbeten të njëjta. Pason një koment për kriteret konkrete:

- a) Palët e interesuara të cilave u dedikohet mekanizmi duhet të kenë besim në të që të vendosin ta shfrytëzojnë. Një prej faktorëve më të rëndësishëm në ndërtimin e besimit tek palët e involvuara është sigurimi se palët në procedurën ankimese nuk mund të ndikojnë ndaj zbatimit të saj juridik;
- b) Pengesat në qasje mund të kyçen në mungesë të vetëdijesimit për mekanizmin, gjuhën, nivelin e edukimit, shpenzimeve, lokacionit fizik dhe frikës prej pasojave;
- c) Që të jetë i besueshëm i aplikueshëm, mekanizmi duhet të japë publikisht informacione për procedurën të cilën e siguron. Afatet e rregulluara për çdo fazë duhet të respektohen gjithmonë kur një gjë e tillë është e mundshme, duke e pasur parasysh se ndonjëherë nevojitet fleksibilitet;
- ç) Palët e involvuara të cilat ankohen apo janë në kontest me ndërmarrje afariste jo rrallë kanë qasje më të vogël deri tek informacionet dhe resurset profesionale, ndërsa shpesh nuk kanë as resurse financiare mjaftueshëm për t'i mbuluar. Moszgjidhja e pabarazisë së tillë mund ta vështirësojë zbatimin e procedurës së drejtë, ta dobësojë perceptimin për procedurë të drejtë si edhe ta pengojë arritjen e zgjidhjeve të përhershme;
- d) Komunikimi i rregullt me palët në procedurë për rrjedhën e ankesave individuale mund të jetë me rëndësi kyçe për ruajtjen e besimit në procedurë. Sigurimi i transparencës lidhur me funksionimin e mekanizmit për rrethin më të gjerë të palëve të involvuara, përmes publikimit të të dhënave statistikore, studimeve të rastit apo informacioneve më të detajuara për zgjidhjen e disa lëndëve të caktuara mund të jetë i rëndësishëm që të demonstron legjitimiteti i mekanizmit dhe të ruhet besimi në të;
- dh) Shpesh, ankesat nuk formulohen nga aspekti i të drejtave të njeriut dhe shumë prej tyre fillimisht nuk tregojnë për brengosje për shkeljen e të drejtave të njeriut. Megjithatë, aty ku rezultatet kanë pasojë për të drejtat e njeriut, duhet të ndërmerren masa që të sigurohet se ato janë në përputhje me të drejtat e njeriut të pranuar ndërkombëtarisht;
- e) Analiza e rregullt për shpeshimin, karakteristikat dhe shkaqet për ankesat mund t'u mundësojë institucioneve të cilat menaxhojnë me këto mekanizma t'i përcaktojnë dhe të ndikojnë ndaj politikave, procedurave apo praktikave të cilat duhet të ndryshojnë që të parandalohet një dëm i ardhshëm eventual;

- ë) Konsultimet me grupet e palëve të involvuara lidhur me dizajnin dhe funksionimin e mekanizmit ankimes në nivel operativ mund të kontribuojnë drejt sigurimit se mekanizmi do t'i plotësojë nevojat e tyre, se ato do ta përdorin në praktikë dhe se ekziston interes i përbashkët për suksesin e tij. Duke e pasur parasysh atë se është jolegjitime ndërmarrja afariste në të njëjtën kohë të jetë edhe lëndë e ankesës dhe në mënyrë të njëanshme ta zgjidh atë, këto mekanizma duhet të fokusohen në arritjen e zgjidhjes së përbashkët përmes dialogut. Aty ku është e nevojshme, arbitrazhi mund ta zbatojë mekanizmin legjitim dhe të pavarur të ndonjë pale të tretë.





Emri i projektit:
Nxitja e parimeve për biznes
dhe të drejta të njeriut

Donator:
Bashkimi Evropian
(IPA: EuropeAid/155319/DD/ACT/MK)

Periudha e implementimit:
01.03.2018 – 31.12.2019



Kontakti:
rr. „Vladimir Polezhinovski“ nr.19-1/6, 1000 Shkup
tel: +389 (0)2 3224 198
E-mail: konekt@konekt.org.mk



Photos: © shutter
Designed and printed by the Publishing Service, United Nations